

Termet e Referencës

“Rishikimi dhe përditësimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve”

I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barazinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

III. OBJEKTIVI I DETYRËS

Qëllimi i këtij angazhimi është rishikimi i plotë dhe përditësimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve të HANDIKOS, në mënyrë që ajo:

- të jetë në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijëve;
- të adresojë në mënyrë specifike rreziqet dhe nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- të forcojë mekanizmat e përgjegjshmërisë dhe raportimit brenda organizatës;
- të shërbejë si dokument udhëzues për të gjitha aktivitetet dhe projektet që përfshijnë fëmijë.

IV. KUALIFIKIMI

- Përvojë në mbrojtjen e fëmijëve (child safeguarding/child protection);
- Njohuri mbi të drejtat e fëmijëve dhe standardet ndërkombëtare relevante;
- Përvojë ose njohuri në punën me fëmijë me aftësi të kufizuara përbën përparësi;
- Aftësi të mira analitike dhe shkrimore;
- Përvojë në hartimin ose rishikimin e politikave institucionale.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për:

- Analizimin e Politikës ekzistuese për Mbrojtjen e Fëmijëve e HANDIKOS dhe dokumentet përkatëse;
- Identifikimin e boshllëqeve dhe nevojave për përmirësim, veçanërisht në raport me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Integrimin e standardeve dhe praktikave ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijëve;
- Konsultimin me stafin relevant dhe pikat fokale për mbrojtjen e fëmijëve gjatë procesit të rishikimit;
- Hartimin e një Politike të përditësuar, të qartë dhe të zbatueshme.

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Shkurt/ Mars 2026 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Angazhimi mbi rishikimin dhe përditësimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve	4 ditë
Fasilitimi i takimit dhe prezantimi i Politikës së përditësuar me stafin e HANDIKOS	1 ditë
TOTALI	5 ditë

VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas ofertës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo, pas finalizimit dhe aprovimit të dokumentit/raportit.

HANDIKOS do të realizojë pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozimi financiar.

Aplikimet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org.

Ju lutem, shkruani në subjekt “Rishikimi dhe përditësimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve”.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 15 shkurt.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen.

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual**
— **PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.